



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 11 dhe 40 shkronja j) të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, nenit 18 paragrafi 1 të Ligjit për bashkëpunim ndërkombëtar nr.04/L-010, nenit 6 paragrafi 3 të Rregullores së MAPL-së për procedurën e bashkëpunimit ndërkombëtar nr.0203-1334 të datës 18.12.2012, neneve 4 dhe 34 paragrafi 2.10 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.01-020/01-0050862/19, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 30 tetor 2020, miratoi,

VENDIM

PËR AUTORIZIMIN E FILLIMIT TË KONSULTIMEVE PËR BASHKËPUNIM KOMUNAL NDËRKOMBËTAR – BINJAKËZIM ME QYTETIN AMES TË SHTETIT TË IOWA NË SHTETET E BASHKUARA TË AMERIKËS

Neni 1

z.Nexhmi Rudari, Nënkryetar i Komunës, në cilësinë e ushtruesit të detyrës dhe kompetencës së Kryetarit të Komunës së Podujevës, të autorizohet për fillimin e konsultimeve për vendosjen e bashkëpunimit komunal ndërkombëtar në formën e binjakëzimit në mes të Komunës së Podujevës dhe Qytetin e Ames të shtetit të Iowa në Shtetet e Bashkuara të Amerikës

Neni 2

Të identifikohen interesat e përbashkëta dhe në pajtim reciprok, konform legjislacionit në fuqi, të përgatitet draft Marrëveshja për bashkëpunim të ndërsjellë mes dy Qyteteve.

Neni 3

Draft Marrëveshja sipas neneve paraprake të këtij vendimi, nënshkruhet nga z.Nexhmi Rudari, Nënkryetar i Komunës, në cilësinë e ushtruesit të detyrës dhe kompetencës së Kryetarit të Komunës së Podujevës, pas vlerësimit të ligjshmërisë nga Ministria e Pushteti Lokal.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Pushtetit Lokal si dhe publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform nenit 81 të ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, dhe nenit 9 paragrafi 8 të Rregullores (QRK) nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave.

Nr.01-104/02-0065939/20
Podujevë,
30 tetor 2020



Kryesuesi i Kuvendit
Fatmir Gashi